

KRISHTËRIMI DHE ISLAMI NË DHEUN E SHQIPTARËVE

Nuk kemi asnjë mënyrë ta ndryshojmë të kaluarën, por vetëm të bëjmë të pamundurën për ta njohur e kuptuar, për të jetuar mirë të tashmen e për të na shërbyer për të ardhmen.

Historia jonë si popull është e gjitha një përpjekje e vazhdueshme për të qenë të lirë. Të vendosur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, ilirët/arbrit/ shqiptarët, ia dolën të mbijetojnë, edhe pse ndër mijëvjeçarë njohën egërsinë e pushtimeve romake, të popujve barbarë të zbritur nga Veriu i Europës e stepat e Siberisë dhe së fundmi të osmanëve. Pozicioni gjeografik ivendit tonë, për shkak të rrugëve që lidhin Perëndimin me Lindjen, por natyrisht edhe pasuritë natyrore të tij, kanë qenë vazhdimisht objekt i lakmive të fqinjëve të vjetër e të rinj.

Nisur nga sa më lart, është e kuptueshme që në këtë trevë të stërlashtë të ketë një pasuri të jashtëzakonshme njerëzore. Shkëmbimet e ndërthurjet e kulturave të popujve të ndryshëm autoktonë apo edhe të atyre të ardhur rishtas e kanë pasuruar mozaikun e asaj që nuk preket me dorë apo shihet me sy, por që është e pranishme në gjithçka të botës së brendshme shpirtërore të banorëve të kësaj treve.

Fatkeqësisht, pushtimet e huaja kanë bërë që ne sot të mos kemi as monumente bronzi, as statuja të mermerta, as edhe arkiva e biblioteka me anë të të cilave të mësojmë për të kaluarën e brezave të shkuar. Në këto kushte, historianët e studiuesit e fushave të tjera e kanë të vështirë për të na e përcjellë vërtetësisht të kaluarën tonë si komb. Gjithsesi atyre munden t'u vijnë në ndihmë arkeologët, gjuhëtarët apo edhe arkivat e bibliotekat e vendeve të tjera, por ajo që ende paraqet vështirësi dhe për të cilën ka shumë diskutime e debate është bota shpirtërore e shqiptarëve e në veçanti përjasja e tyre ndaj besimit fetar.

Një i huaj që vizitoi vendin tonë, kur sapo kishte ndodhur përmbysja e regjimit komunist, gjatë një bisede me intelektualë shqiptarë mbi çështje të ndryshme rreth historisë sonë, marrëdhënieve tona me Europën dhe natyrisht mbi atë ç'ka kishte ndodhur në Shqipëri gjatë gati 50 vjetëve të diktaturës komuniste, bëri një konstatim paksa të veçantë mbi faktin e ekzistencës së një mjedisi krejtësisht paqësor përsa i takon sferës së besimit fetar ndër shqiptarët. Sipas tij, "shqiptarët janë kriptokristianë, por ndoshta do të ishte më korrekt të thuhej kriptopaganë". A ka ndonjë element vërtetësie, pra të bazuar në fakte, dokumente, objekte për këtë, apo është thjesht një perceptim a ndjesi e këtij vizitori të huaj?

Më poshtë do të përcjell disa mendime e ide jo vetëm rreth këtij konstatimi, por sidomos për faktin tashmë të pranuar botërisht nga të gjithë, që vendi ynë është një shembull për t'u ndjekur përsa i takon besimit fetar dhe bashkëjetesës ndërjetare.

Nëse do të rrëfenim me pak fjalë historinë e rënies së statujave të perëndive pagane dhe përqaftimin nga popujt e kontinentit tonë të një feje të re, krishtërit, do të mjaftonte vetëm pohimi i faktit se ilirët, paraardhësit tanë, qenë ndër të parët që e përqaftuan këtë fe, që do të ndryshonte fatet e njerëzimit. Ishte një perandor ilir, Kostandini, ai që e ligjëroi këtë besim pas shekujsh persekutimi të egër. Sipas dëshmive të kohës, Shën Pali përpara se të hidhej në bregun tjetër të Adriatikut ka kaluar në trojet tona e kuptohet se ia ka dalë të predikojë, duke patur kësisoj edhe ithtarët e parë të këtij besimi.

Nga vitet e sundimit të Kostandinit (288-337) e deri në mbërritjen e osmanëve në portat e Europës, në trojet tona ka zhvillime të shumta në rrafshin politiko-shoqëror-ekonomik-kulturor, e natyrisht edhe në atë shpirtëror. Janë shekuj transformimesh të mëdha në këtë pjesë të Europës Jugindore, sidomos përsa i takon ndryshimeve në rrafshin demografik. Dyndjet e popujve sllavë, të cilët kishin përqaftuar edhe ata këtë besim të ri, kishin tkurrur ndjeshëm dhe shpesh në mënyrë përfundimtare trojet e banuara nga banorët autoktonë, ilirët. Në rrafshin shpirtëror, përplasjet e forta për të marrë supremacinë, midis kishës greko-bizantine të Kostandinopojës dhe dishepujve të Cirilit e Metodit, të mbështetur nga mbretëria bullgare, përfunduan më 1019, kur këta të fundit u mundën keqas nga Perandori Basili II.

Ndërsa shizma e madhe e vitit 1054 midis kishës romane e asaj bizantine ndau pothuaj në dysh trojet shqiptare. Kjo ndarje e ndikimeve përsa i takon ritit të përdorur në vendet e kultit, por jo të besimit, që vazhdonte të ishte i krishterë, ndikoi veçanërisht në rrafshin kulturor e shpirtëror. Vlen për t'u vënë në dukje se gjuhët e përdorura gjatë ceremonive fetare ishin latinishtja dhe greqishtja.

Ndërmjet këtyre dy zonave të ndikimit fetar të kahershëm, gjatë shekullit XI ndërhyu edhe kisha e mbretërisë serbe të Rashës. Në këtë mbretëri ritet fetare kryheshin sipas ritit greko-bizantin, me të vetmin ndryshim, që gjuha e përdorur ishte ajo sllave apo paleosllave.

Duhet të vëmë në pah se pavarësisht përdorimit të gjuhëve të huaja gjatë kryerjes së riteve fetare, ato mbetën vetëm të tilla, pra gjuhë liturgjike, pa u bërë kurrë gjuhë e folur nga populli.

Nga të dhëna të ndryshme të drejtpërdrejta apo edhe të tërthorta, zbulimet arkeologjike, dëshmi të shkruara me prejardhje të ndryshme, studime etnografike, gjuhësore, të besimit, artit vizual, arkitekturës etj., rezulton se në trojet tona përqafimi i besimit monoteist të krishterë ka depërtuar apo është përqafuar fillimisht nga banorët e qendrave të mëdha, pra nga qytetet. Zonat më të largëta kanë vonuar për t'u përfshirë në këtë lëvizje të madhe që i përket botës shpirtërore njerëzore. Paganizmi vazhdoi për një kohë relativisht të gjatë të jetonte përkrah krishtërit, e padyshim në mjaft raste edhe duke u ndërthurur me këtë të fundit.

Në shekullin XIV, kur për herë të parë shfaqen në trojet tona ushtritë osmane, e tërë popullata kishte përqafuar fenë e krishterë, qoftë atë të ritit latin perëndimor, qoftë atë të ritit bizantin lindor. Beteja e Savrës midis familjeve Topia e Balsha më 1385-ën shënon datën që i parapriu pushtimit gati 5-shekullor osman. Është shumë interesant fakti që sulltan Murati II dërgoi forca ushtarake në ndihmë të Topiajve të udhëhequra nga dy komandantë, njëri prej të cilëve ishte Evrenoz Beu, një grek i konvertuar në fenë islame. Kjo ishte një dëshmi e qartë e tejet domethënëse se tashmë përqafimi i një besimi të ri kishte nisur ndër popujt e gadishullit tonë.

Por, do të jetë shekulli XV ai që shënoi fillimin e një procesi të gjatë e shumë të ndërlikuar të pranimit prej shqiptarëve të një besimi të ri të ardhur edhe kësaj here nga Lindja e Afërt, islamit.

Shumë është folur e shkruar për përfaqimin e këtij besimi fetar nga ana e shqiptarëve. Këndvështrimet kanë qenë e vazhdojnë të jenë nga më të ndryshmet, e jo rrallëherë edhe në kundërshti të forta ndërmjet tyre, jo vetëm përsa i takon faktit të konvertimit, por sidomos për pasojat e tij në zhvillimet e mëtejshme historike të vendit. Nëse do të përpiqeshim të bënim një përmbledhje të shkurtër të të gjitha atyre pikëpamjeve e ideve që studiuesit e ndryshëm na kanë paraqitur ndër vite, mendoj se mund t'i grupojmë përafërsisht në:

Ata që mendojnë se shqiptarët u konvertuan për shkak të dhunës fizike, taksave e tatimeve të rënda që kërkoheshin nga pushtuesit e rinj.

Ata që mendojnë se shqiptarët u joshën nga privilegjet, gradat e ofiqet në administratën stërmadhe të perandorisë osmane.

Arsyet e mësipërme janë plotësisht të vërteta, jo vetëm për ne shqiptarët, por edhe për popujt e tjerë ballkanas. Megjithatë ato nuk janë të vetmet arsye që i detyruan shqiptarët të braktisin besimin e krishterë e të përqaфонin fenë e re.

Nga disa dokumente origjinale të shekullit XVIII, që fatmirësisht i kanë shpëtuar rrebesheve të kohrave dhe që ruhen pranë Arkivit Qendror Shtetëror, kemi mundësi të njihemi me një shqetësim paksa të veçantë, për klerin katolik, atë të përdorimit të dhunshëm të objekteve të kultit katolik nga ana e "shizmatikëve", pra e banorëve sllavë malazezë e serbë në rrethinat e Tivarit e Ulqinit. Sipas klerikëve të lartë katolikë në Shkodër e Tivar, të cilët njoftojnë edhe Selinë e Shenjtë, "përdorimi nga ana e banorëve sllavë i kishave të lashta katolike bëhet me të vetmin qëllim, atë të asimilimit të katolikëve, pra banorëve autoktonë, shqiptarëve". Për të bërë të mundur që ky qëllim ogurzi të mos arrihet, ata kërkojnë me këmbëngulje ngritjen e kishave të reja.

Ndërsa nëse do të flisnim për atë ç'ka ndodhte në vendet e kultit të krishterë të rritit ortodoks, përpjekja për asimilim vinte nëpërmjet përdorimit të gjuhës greke jo vetëm gjatë ceremonive fetare, por edhe trysnisë për të mësuar e përdorur këtë gjuhë edhe në jetën e përditshme.

Duket qartas se përpjekjet për të asimiluar shqiptarët kanë qenë të pranishme për shekuj me radhë dhe mjetet e përdorura për t'ia dalë mbanë kanë qenë të shumëllojshme, përfshirë këtu

edhe ato që i takojnë botës shpirtërore të njeriut. Në këto kushte, një pjesë jo e vogël e shqiptarëve, të gjendur përballë një trysnie krejtësisht të pakuptimtë për ta, (Për shqiptarët, një prej popujve më të vjetër europianë, kombësia nuk ka lidhje me besimin, pasi e para trashëgohet gjenetikiisht, pra nuk mund ta zgjedhësh, ndërsa i dyti, besimi, është tërësisht dhe pa asnjë dyshim zgjedhje individuale), zgjodhën rrugën e praktikimit të një besimi lehtësisht të dallueshëm nga ai i fqinjëve të vjetër e të rinj.

Pra, arsyeve të mësipërme, pa mëdyshje mund t'i shtohet edhe kjo mundësi, e cila ka gjithsesi të njëjtin motiv, atë të mbijetesës si komb.

Shekujt e sundimit osman sjellin një pamje të re përsa i takon besimeve fetare të praktikuara nga shqiptarët. Dy besimeve të para të krishtera, të ritit katolik e ortodoks, i shtohet ai islam. Me kalimin e viteve e dekadave edhe besimi islam pëson shizma, bektashi, e mjaft tarikate, që gjithashtu bëhen pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve. E megjithatë, ky realitet i ri në rrafshin shpirtëror, në atë të besimit fetar, nuk e preku aspak përkatësinë etnike të shqiptarëve. Pjesëtarët e të gjitha komuniteteve fetare ruajtën me një besnikëri të pashoqe përkatësinë etnike, që shprehej qartësisht në zakonet, traditat e përbashkëta e veçanërisht në ruajtjen e gjuhës shqipe. Shqiptarët, tashmë kishin formësuar një konstitucion të përbashkët shpirtëror dhe një vetëdije kombëtare, pasi siç rezulton edhe nga pohimet e vetë autoriteteve osmane, “nuk kishte mundur ta lëkundte as ekzistenca e praktikimit të disa besimeve ndër ta”.

Për të vërtetuar këtë tezë na vjen në ndihmë një dokument i gjetur në arkivat e republikës turke.

Në fund të shtatorit të vitit 1861, dërgohet në Shkodër, Ahmet Xhevdet Pasha, si komisar i jashtëzakonshëm i sulltan Abdyl Hamitit II për të verifikuar gjendjen politike, ekonomike e shoqërore në Vilajetin e Shkodrës, si rezultat i acarimit të marrëdhënieve të valiut me popullatën vendase. Ndërsa ai po kryente detyrën e ngarkuar nga Porta e Lartë, nga Stambolli i vjen një tjetër kërkesë, që ai “duhet të punonte për të gjetur gjuhën e përbashkët midis të krishterëve e myslimanëve në këtë vilajet”. Përgjigja që Ahmet Xhevdet Pasha i përcjell Sulltanit paraqet mjaft interes për temën që diskutojmë sot.

Ndër të tjera ai njofton Sulltanin:

“..sa për gjetjen e gjuhës së përbashkët mes të krishterëve dhe myslimanëve, ajo është në një shkallë të paparë në krahasim me ndonjë vend tjetër. Ata përshëndeten miqësisht me njëri-tjetrin. Katolikët shkojnë në beteja pas bajraktarëve myslimanë, ashtu sikundër myslimanët shkojnë pas bajraktarëve katolikë. Në luftë sillen si një trup i vetëm. Të vrarët në betejë i respektojnë duke i quajtur të gjithë dëshmorë. Në fshatrat e përziera katolikët kontribuojnë në pagën mujore të hoxhallarëve, ashtu sikundër edhe myslimanët kontribuojnë në pagën e priftërinjve.. Porta e Lartë më tërheq vëmendjen dhe më urdhëron të gjej gjuhën e përbashkët mes myslimanëve dhe të krishterëve, ngaqë nuk ka dijeni dhe nuk njeh mirë situatën e popullit të këtushëm”.

Si përfundim, mund të themi:

Faktet nuk mungojnë për të vërtetuar pa asnjë mëdyshje se pavarësisht besimit fetar, (Feja në vetvete është një dogmë dhe rrjedhimisht nuk mundet të pranojë një tjetër ose edhe nëse e pranon mundohet të vërtetojë se vetëm ajo është në të drejtën e saj), shqiptarët ia kanë dalë të kapërcejnë çdo lloj pengese në këtë drejtim, duke i dëshmuar botës mbarë se sfera e besimit është thjesht një çështje individuale.

Duhet të pranojmë se vetëm një mendje e hapur, një shpirt i lirë dhe krenaria për përkatësinë e tyre kombëtare i ka bërë banorët e këtij dheu të bekuar të jenë kaq të veçantë. Mbijetesa jonë si komb i dedikohet edhe këtij fakti. Dheu i shqiptarëve nuk njohu kurrë luftë vëllavrasëse për shkaqe të besimit fetar, rast ky unikal në botë.